A.K.P.A.
Nr 2 Prot.
Datë,më 06 01 .2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 1332/1 prot.

Tiranë, më 30.12.2024

Lënda: Shpallje vendi vakant

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**Tiranë**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar, shpall:

- **1 (një) vend vakant për pozicionin "Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve", në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.**

Bashkëlidhur një kopje e njoftimit, i cili është dërguar edhe në formë elektronike në adresën: vendetelirapune@akpa.gov.al.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Sokol Çomo**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

## SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar,

- **Shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin "Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve", në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.**

## KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST PËR ZBARDHJEN DHE REDAKTIMIN E VENDIMEVE" :

a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë, në degën "Gjuhë-Letërsi";

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

c) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në profesion.

## KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Marrëdhënia e punës me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", të ndryshuar.
- Bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar, kategoria e pagës për pozicionin "Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve", është **IV-1**.
- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 27.11.2024.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 31 dhjetor 2024 deri më 17 janar 2025, në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës **17 janar 2025**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data **31 dhjetor 2024 deri më 17 janar 2025**, në adresën rekrutime@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dokument që vërteton që nuk ka çështje gjyqësore në ngarkim;
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
6. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
7. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike,** nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-8.

A.K.P.A.
Nr 2/1 Prot.
Datë,më 06 01 2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 1331/1 prot. Tiranë, më 30.12.2024

Lënda: Shpallje vendi vakant

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**Tiranë**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar, shpall:

- **3 (tre) vende vakante për pozicionin "Përkthyes", në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.**

Bashkëlidhur një kopje e njoftimit, i cili është dërguar edhe në formë elektronike në adresën: vendetelirapune@akpa.gov.al.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**Sokol Çomo**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

## SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar,

- **Shpall 3 (tre) vende vakante për pozicionin "Përkthyes", në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.**

**<u>KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":</u>**

a) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimalisht 5 (pesë) vjet eksperiencë në përkthim shqip – anglisht – shqip;

b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;

c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

**<u>KUSHTE TË PËRGJITHSHME</u>**

- Marrëdhënia e punës me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", të ndryshuar.
- Bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", të ndryshuar, kategoria e pagës për pozicionin "Përkthyes", është **II-1**.
- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 27.11.2024.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 31 dhjetor 2024 deri më 17 janar 2025, në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës **17 janar 2025**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data **31 dhjetor 2024 deri më 17 janar 2025**, në adresën rekrutime@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dokument që vërteton që nuk ka çështje gjyqësore në ngarkim;
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
6. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
7. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike,** nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-8.

A.K.P.A.
Nr 2/2 Prot.
Datë,më 06 01 2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KRUJË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE**

**Nr.** 9469 **Prot.** **Kruje , më** 30.12**.2024**

Lënda: Dërgim materiali për shpallje për verifikim paraprak të lëvizjes paralele

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**TIRANË**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe VKM-së nr.243, datë 18/03.2015 " Për pranimin , lëvizjen paralele . periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive, Njësia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Kruje, dërgon shpalljen për pozicioni:

**1 (një) Pozicion - Specialist për ndihmën ekonomike , Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë. Kategoria e pagës IV-3.**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e nevojshëm për publikimin e njoftimit në faqen tuaj zyrtare vendetelirapune@akpa.gov.al. Kopje e këtij dokumentacioni është dërguar edhe nëpërmjet e-mail–it në adresën tuaj elektronike vendetelirapune@akpa.gov.al

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ju urojmë gjithë të mirat!*

**Kryetari I Bashkise**

**ARTUR BUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KRUJË -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

**NJOFTIM MBI PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Kruje më 30 .12.2024**

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015 " Për pranimin, lëvizjen paralele,periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të Këshillit të Ministrave, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Krujë, njofton se :

Nga verifikimi i kryer pranë sektorit të arkiv – protokollit dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore, rezulton se **NUK** është paraqitur asnjë aplikim për lëvizje paralele, për këtë proçedurë nga nëpunës civilë të së njëjtës kategori,vazhdon proçedura për pranimin në shërbimin civil në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil, për pozicionet si më poshtë :

**1 (një) Pozicion - Specialist për ndihmën ekonomike , Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë. Kategoria e pagës IV-3.**

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

**1.Sabije Seseri Drejtor I Burimeve Njerezore**

**2.Ilira Suta , Drejtor I Sherbimit Social**

**3.Matilda Citozi , Specialiste Personeli**

**4.Elida Karaj , Specialiste rekrutim /kualifikim**

**5.Marina Kurti , Specialiste Juriste**

A.K.P.A.
Nr 2/3 Prot.
Datë,më 06.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

Nr. 9308 Prot. Kruje , më 24.12.2024

Lënda: Dërgim materiali për shpallje për verifikim paraprak të lëvizjes paralele

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**TIRANË**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe VKM-së nr.243, datë 18/03.2015 " Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive, Njësia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Kruje, dërgon shpalljen për pozicioni:

**1 (një) Pozicion - Specialist Per Inspektimet dhe kontrollet e Subjekteve ne Terren , Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**

**1 (një) Pozicion - Specialiste e Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit, Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e nevojshëm për publikimin e njoftimit në faqen tuaj zyrtare vendetelirapune@akpa.gov.al. Kopje e këtij dokumentacioni është dërguar edhe nëpërmjet e-mail–it në adresën tuaj elektronike vendetelirapune@akpa.gov.al

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ju urojmë gjithë të mirat!*

Kryetari I Bashkise

ARTUR BUSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

# NJOFTIM MBI PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

**Kruje më 24 .12.2024**

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015 " Për pranimin, lëvizjen paralele,periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të Këshillit të Ministrave, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Krujë, njofton se :

Nga verifikimi i kryer pranë sektorit të arkiv – protokollit dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore, rezulton se **NUK** është paraqitur asnjë aplikim për lëvizje paralele, për këtë proçedurë nga nëpunës civilë të së njëjtës kategori,vazhdon proçedura për pranimin në shërbimin civil në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil, për pozicionet si më poshtë :

**1 (një) Pozicion - Specialist Per Inspektimet dhe kontrollet e Subjekteve ne Terren , Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**

**1 (një) Pozicion - Specialiste e Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit, Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

**1.Sabije Seseri Drejtor I Burimeve Njerezore**

**2.Ilira Suta , Drejtor I Sherbimit Social**

**3.Matilda Citozi , Specialiste Personeli**

**4.Elida Karaj , Specialiste rekrutim /kualifikim**

**5.Marina Kurti , Specialiste Juriste**

A.K.P.A.
Nr 2/4 Prot.
Datë,më 06 01 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 9470 Prot.

Kruje, më 30. 12. 2024

Lënda: Dërgim materiali për përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak për pranimin në shërbimin civil

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**TIRANË**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe Kreut II të VKM-së nr.243, datë 18/03.2015 " Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive, Njësia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Krujë, dërgon materialet për perfundimin e procedurës së verifikimit paraprak per pranimin në shërbimin civil:

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e nevojshëm për publikimin e njoftimit në faqen tuaj zyrtare vendetelirapune@akpa.gov.al Kopje e këtij dokumentacioni është dërguar edhe nëpërmjet e-mail–it në adresën tuaj elektronike vendetelirapune@akpa.gov.al

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ju urojmë gjithë të mirat!*

**KRYETARI I BASHKISE**

**ARTUR BUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**NJOFTIM MBI PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË VERIFIKIMIT PARAPRAK PER PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL**

**Kruje, më 30.12.2024**

Në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Kreu II dhe IV "Konkurrimi", pika 1, shkronja a, të VKM-së nr. 243 datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të pranimit në shërbimin civil dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim për procedurën e shpallur për konkurim për grupin e pozicioneve:

**1 (një) Pozicion - Specialist Per Inspektimet dhe kontrollet e Subjekteve ne Terren , Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**
**1 (një) Pozicion - Specialiste e Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit, Drejtoria Tatim Taksave , Kategoria e pagës IV-2.**

**Njofton se:**

**I.**Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicioneve të lira dhe që kualifikohen për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit është si më poshtë:

**1. Xhensila Xixa**
Testimi me shkrim do të zhvillohet në datë **06.01.2025 ora 10:00** në ambientet e Bashkisë Krujë, kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim dhe dosjen personale më shumë se 45 pikë do të kalojnë në intervistën e strukturuar me gojë që do të njoftohet për secilin kandidat të kualifikuar me e-mail.

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

1.Sabije Seseri, Drejtor i Burimeve Njerëzore
2.Ilira Suta , Drejtor i Shërbimit Social
3.Matilda Citozi , Specialiste Personeli
4.Marina Kurti , Specialiste Juriste
5.Elida Karaj , Specialiste rekrutim /kualifikim

A.K.P.A.
Nr 2/5 Prot.
Datë,më 06.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE**
**DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 10821/15 prot.

Tiranë, më 30.12.2024

**Lënda: Njoftim i fituesit për pozicionin e punës Punëtor varrezash në Njësinë Administrative Farkë**

**SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT**

Agjencia e Shërbimeve Funerale nëpërmjet komunikimit elektronik dhe në formë shkresore, ju dërgon bashkëlidhur kësaj shkrese njoftimin e fituesit për proçedurën e konkurimit për pozicionin Punëtor varrezash në Njësinë Administrative Farkë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Raimonda Shino**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE**
**DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

## SHPALLJE E FITUESIT

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2784 prot., datë 19.01.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Funerale, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë", Njësia e Burimeve Njerëzore në përfundim të vlerësimit për procedurën e konkurimit për një vend të lirë pune shpall fituesin për pozicionin:

**Punëtor varrezash në Njësinë Administrative Farkë**

Fituesi për pozicionin Punëtor varrezash është si më poshtë vijon:

1. Beaze Stojku

Njoftohet fituesi i mësipërm për tu paraqitur pranë zyrave të Agjencisë së Shërbimeve Funerale, me datë 31.12.2024.

BASHKIA TIRANË

A.K.P.A.
Nr 2/6 Prot.
Datë,më 06 01 2025

B40
Balkan Cities Network

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE**
**DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 1083/15 prot.

Tiranë, më 30.12.2024

**Lënda: Njoftim i fituesit për pozicionin e punës Specialist i Marrëdhënieve me Publikun e Median**

**SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT**

Agjencia e Shërbimeve Funerale nëpërmjet komunikimit elektronik dhe në formë shkresore, ju dërgon bashkëlidhur kësaj shkrese njoftimin e fituesit për proçedurën e konkurimit për pozicionin Specialist i Marrëdhënieve me Publikun e Median.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Raimonda Shino**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE - BASHKIA TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE**
**DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

## SHPALLJE E FITUESIT

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2784 prot., datë 19.01.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Funerale, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë", Njësia e Burimeve Njerëzore në përfundim të vlerësimit për procedurën e konkurimit për një vend të lirë pune shpall fituesin për pozicionin:

- **Specialist Marrëdhënie me Publikun e Median**

Fituesi për pozicionin Specialist Marrëdhënie me Publikun e Median është si më poshtë vijon:

- Znj. Bejana Kruja

Njoftohet Znj. Bejana Kruja për tu paraqitur pranë zyrave të Agjencisë së Shërbimeve Funerale, me datë 31.12.2024.



Adresa: Rruga e "Durrësit" nr 132, Tiranë

A.K.P.A.
Nr 2/7 Prot.
Datë,më 06 01 .2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**

**Nr.** 11017 **Prot.** **Kamëz më** 26 . 12 **.2024**

**Lënda:** Kërkesë për shpallje pozicionesh të lira pune.

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

**Tiranë.**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM-së nr. 118, date 05.03.2014 i ndryshuar " Pë Procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" si dhe VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", ju bëjmë me dije se, Bashkia Kamëz shpall si pozicione të lira pune,

1. Sekretar i Përgjithshëm;
2. Drejtor i Prokurimeve Publike;
3. Specialist i sektorit te Kontrrollit ne Terren, drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit;

Sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për publikimin në ëebsiten e Shërbimit Kombëtar të Punësimit të njoftimeve për shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin e mësipërme.

Njoftimi për shpallje për pozicionin e mësipërme do ju dergohet nëpërmjet emailit .

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj;

**KRYETARI**

**Rakip SULI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KAMËZ

Adresa: Bulevardi "Nene Tereza", nr. 492 Kamëz, tel.: +355 47 200 177, e-maili: info@kamza.gov.al, web:www.kamza.gov.al

A.K.P.A.
Nr 2/8 Prot.
Datë,më 06 01 2025

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr 18826/4 Prot.

Vlorë, më 26.12 2024

Lënda: Kërkesë për shpallje në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Tiranë

Në zbatim të VKM nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" bashkëlidhur shpalljen e rezultatit paraprak për pocedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil, për plotësimin e vendit të lirë të punës në pozicionin: "Përgjegjës" në Sektorin e menaxhimit të e-kërkesave dhe e-ankesave, Drejtoria e Bashkëqeverisjes, Bashkia Vlorë.

Sa më sipër njoftimi duhet të shpallet në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit http://shpk.gov.al/

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORE

Laura Brinja

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA VLORË

P.S
Kjo kërkesë do t'ju njoftohet edhe në rrugë elektronike nga adresa e emailit: burimenjerezore@vlora.gov.al

ASHKIA VLO

## 26.12.2024 SHPALLJE E REZULTATIT PARAPRAK "PËRGJEGJËS" NË SEKTORIN E MENAXHIMIT TË E-KËRKESAVE DHE E-ANKESAVE, DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Në zbatim të ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në vijim të procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendit të lirë në pozicionin "Përgjegjës" në Sektorin e menaxhimit të e-kërkesave dhe e-ankesave, Drejtoria e Bashkëqeverisjes. Bashkia Vlorë me procedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese. sipas parashikimeve të nenit 26 të ligjit. KPP shpall rezultatin paraprak të konkurentëve të cilët kanë grumbulluar mbi 70 pikë:

1. **Arsilda Male**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Bashkia Vlorë

A.K.P.A.
Nr 2/9 Prot.
Datë,më 06 01 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE

Nr 15034/1 prot. Durrës, më 30.12.2024

Lënda: Kërkesë për publikimin e shpalljes për pozicionin e lirë pranë Drejtorisë së Buxhetit

**SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**
**Bulevardi "B.Curri", pranë ish hotel "Arbana"**
**Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM, nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, në Vendimin nr.87 datë 10.10.2024 "Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës", në Urdhrin, nr.472, 15034 prot. datë 24.12.2024 "Për shpalljen e konkurimit për pozicionin e lirë" kërkojmë publikimin e shpalljes për pozicionin :

Specialist në Sektorin e Analizës , Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm pranë Drejtorisë së Buxhetit.

Bashkëlidhur shpallja.

**ZËVENDËSKRYETAR**

**Gentian Kallmi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**

**DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE**

## SHPALLJE PËR POZICION TË LIRË

Në zbatim të ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive, i ndryshuar, në Vendimin nr.87 prot. 11785 datë 10.10.2024 "Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës", si dhe në Urdhrin nr.472, 15034 prot. datë 24.12.2024 "Për shpalljen e konkurimit për pozicionin e lirë", Bashkia Durrës shpall konkurimin për këtë pozicion:

**Specialist Sektori i Analizës, Statistikës dhe Planifikimit Afatmesem pranë Drejtorisë së Buxhetit**

***Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranim nga jashtë shërbimit civil.***

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për: LËVIZJE PARALELE**
**08.01.2025**
**Afati për dorëzimin e dokumenteve për: PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**
**13.01.2025**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Zbaton me përpikmëri dhe me nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër.

Eshte pergjegjes për cilësinë dhe saktesinë e materialeve të përgatitura.

Organizon sistemimin e informacionit për sektorin ku bën pjese .

Punon në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetiake tekniko- profesionale në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar por edhe të karrierës në shërbimin civil, në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Punon për mbledhjen e të dhënave statistikore nepermjet anës shkresore,nga institucionet jashtë bashkisë, ndërmarrjet në varësi të Bashkisë dhe drejtoritë e institucionit të bashkise.

Punon në hedhjen dhe perpunimin e të dhënave statistikore në vazhdimsi, të zhvillimit ekonomik,turizmit,tregut të punës, arsimit, transportit, ndihmës ekonomike, shërbimeve, investimeve në infrastrukturë, ndriçim, gjelbërim për Bashkinë Durrës( per 6 njesite).

Punon për krijimin e data-base të ish komunave dhe hedhjen e të dhënave në vazhdimësi.

Azhornon data-base statistikor të Bashkisë Durres me të dhëna të reja statistikore në vazhdimesi.

Punon në grup për planifikimin afatmesem.

Punon në grup për organizimin e dëgjesave publike dhe listimin e projekteve prioritare dalë nga këto degjesa Bashkepunon me drejtorine e buxhetit për hedhjen e treguesve të performances për cdo program

EMP.(pas percaktimit nga ana e drejtoreve të çdo programi) për buxhetin afatmesem të Bashkisë.Siguron informacion të thjeshtë dhe të mirë-strukturuar me qëllim që të ndihmojë vendimarrjen e kryetarit të bashkisë, këshillit bashkiak dhe drejtuesve të strukturave bashkiake, përgjegjëse për politikat dhe realizimin e çdo funksioni/shërbimi publik, nëpërmjet mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të përgatitjes së raporteve të performances

Koordinon, mbledh, azhornon, kontrollon dhe publikon të dhëna teknike dhe financiare në lidhje me performancën e bashkisë, duke siguruar cilësi të të dhënave.
Harton dhe shpërndan formate standarte për mbledhjen e të dhënave teknike për matjen e treguesve ( ndryshe "pasaporta e të dhënave").
Sugjeron metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave si edhe verifikimit të cilësisë së të dhënave të mbledhura dhe raportuara;
Ruan, mirëmban dhe administron bazën e të dhënave me të dhënat teknike të shërbimeve/funksioneve të bashkisë dhe treguesve të performancës;
Sugjeron treguesit e monitorimit të performancës të cilët miratohen nga drejtuesit e strukturat përgjegjëse specifike dhe përcillen në mënyrë periodike tek njësia e monitorimit të performancës së bashkisë;
Siguron dhe garanton cilësinë e të dhënave dhe përditësimin e gjithë sistemit të treguesve të performancës periodikisht por jo më pak sesa një herë në vit;
Analizon të dhënat që synojnë të monitorojnë performancën e bashkisë dhe prodhon raporte duke u fokusuar më së shumti në dy produkte standart;
Përgatit raporte të ndryshme sipas nevojës së kryetarit, këshillit bashkiak; komunikimit me publikun apo kërkesave nga institucionet e qeverisjes qendrore;
Ndihmon në monitorimin e planit të përgjithshëm vendor me anë të treguesve të performancës;
Ndërvepron me dhe asiston me strukturat përgjegjëse specifike gjatë procesit të hartimit të projekt buxhetit afatmesëm dhe monitorimit të ekzekutimit të buxhetit me të dhëna teknike;
Mbështet proçesin e konsultimit të dokumentave strategjikë dhe programit buxhetor vjetor apo afatmesëm me aktorët dhe grupet e interesit, si dhe në mënyrë të veçantë, përgatit draftet e integruara të raporteve vjetore të performancës.

## I. LËVIZJA PARALELE

***Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.***

### 1. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

**Arsimi:** *Ekonomik, Drejtësi, Finacier,Kontabilist etj*

a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-2;
b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
d) të ketë eksperiencë 5 vjet dhe notë mesatare mbi 8;
e) të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze
f) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

## 2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard

Fotokopje të diplomës dhe listes se notave.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

Fotokopje të kartes se idenditetit (ID);

Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi "Liria", 2000 Durrës

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 08.01.2025**

## 3. Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **10.01.2025**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

## 4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Kodin e Procedurave Administrative

Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar

Ligji nr. 44/2014 datë 24.4.2014 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"

Ligjin nr. 9131 dt. 08.5.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" Ligji 139 dt. 17.12.2015 ''Për vetqeverisjen vendore'' i ndryshuar

Ligji 17/2018 “Për statistikat zyrtare”
Ligji 30/2022 “Per miratimin e programit te statistikave zyrtare 2022-2026” Ligji 9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” i ndryshuar

**II.**

## 1. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

***a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (40 pikë)***

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperienca, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

***b) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (60 pikë)***

- ✓ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ✓ Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- ✓ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

## 2. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.
Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail).

## III. PËR PRANIMIN NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

***Vetëm në rast se pozicioni në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë.***

Konkurimi është i hapur për pranimin në shërbimin civil në **KATEGORINË EKZEKUTIVE**, sipas parashikimeve të nenit 22 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar

Kandidatët duhet të plotësojnë **KËRKESAT E PËRGJITHSHME** për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar;
b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

## I. TË DHËNAT E POZICIONIT TË PUNËS

**Emërtesa e pozicionit:** Specialist
**Institucioni:** Bashkia Durrës
**Drejtoria:** Drejtoria Buxhetit
**Sektori:** Sektori i Analizës, Statistikës dhe Planifikimeve Afatmesme
**Raporton tek:** Përgjegjësi i Sektorit

Qëllimi i Përgjithshëm i Pozicionit të Punës:

Krijimi i bazes se te dhenave statistikore te zhvillimit demografik, ekonomik dhe social si dhe te gjithe statistikat e tjera per Bashkine Durres, duke bashkepunuar me te gjitha njesite brenda territorit te Bashkise Durres, ndermarrjeve te varesise dhe institucioneve te rendesishme te qytetit per thithjen e informacionit statistikor. Perditesimi dhe publikimi i informacionit statistikor duke sherbyer si qender e informimit statistikor, bazuar ne programin statistikor qe ne bashkepunim me projektin SALSTAT/INSTAT, te avancohet drejt perfeksionimit te statistikave zyrtare, bazuar ne ligjin "Per statistikat zyrtare".
Bashkepunimi me GSBI dhe EMP per Planifikimin afatmesem ne kuader te pergatitjes se Programit te Buxhetit Afatmesem.

## II. DETYRAT KRYESORE

Zbaton me përpikmëri dhe me nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër.
Eshte pergjegjes për cilësinë dhe saktesinë e materialeve të përgatitura.
Organizon sistemimin e informacionit për sektorin ku bën pjese .
Punon në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetiake tekniko- profesionale në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar por edhe të karrierës në shërbimin civil, në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.
Punon për mbledhjen e të dhënave statistikore nepermjet anës shkresore,nga institucionet jashtë bashkisë, ndërmarrjet në varësi të Bashkisë dhe drejtoritë e institucionit të bashkise.
Punon në hedhjen dhe perpunimin e të dhënave statistikore në vazhdimsi, të zhvillimit ekonomik,turizmit,tregut të punës, arsimit, transportit, ndihmës ekonomike, shërbimeve, investimeve në infrastrukturë, ndriçim, gjelbërim për Bashkinë Durrës( per 6 njesite).
Punon për krijimin e data-base të ish komunave dhe hedhjen e të dhënave në vazhdimësi.
Azhornon data-base statistikor të Bashkisë Durres me të dhëna të reja statistikore në vazhdimesi.

Punon në grup për planifikimin afatmesem.Punon në grup për organizimin e dëgjesave publike dhe listimin e projekteve prioritare dalë nga këto degjesa.Bashkepunon me drejtorine e buxhetit për hedhjen e treguesve të performances për cdo program EMP.(pas percaktimit nga ana e drejtoreve të çdo programi) për buxhetin afatmesem të Bashkisë.
Siguron informacion të thjeshtë dhe të mirë-strukturuar me qëllim që të ndihmojë vendimarrjen e kryetarit të bashkisë, këshillit bashkiak dhe drejtuesve të strukturave bashkiake, përgjegjëse për politikat dhe

realizimin e çdo funksioni/shërbimi publik, nëpërmjet mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të përgatitjes së raporteve të performances
Koordinon, mbledh, azhornon, kontrollon dhe publikon të dhëna teknike dhe financiare në lidhje me performancën e bashkisë, duke siguruar cilësi të të dhënave.
Harton dhe shpërndan formate standarte për mbledhjen e të dhënave teknike për matjen e treguesve ( ndryshe "pasaporta e të dhënave").
Sugjeron metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave si edhe verifikimit të cilësisë së të dhënave të mbledhura dhe raportuara;
Ruan, mirëmban dhe administron bazën e të dhënave me të dhënat teknike të shërbimeve/funksioneve të bashkisë dhe treguesve të performancës;
Sugjeron treguesit e monitorimit të performancës të cilët miratohen nga drejtuesit e strukturat përgjegjëse specifike dhe përcillen në mënyrë periodike tek njësia e monitorimit të performancës së bashkisë;
Siguron dhe garanton cilësinë e të dhënave dhe përditësimin e gjithë sistemit të treguesve të performancës periodikisht por jo më pak sesa një herë në vit;
Analizon të dhënat që synojnë të monitorojnë performancën e bashkisë dhe prodhon raporte duke u fokusuar më së shumti në dy produkte standart;
Përgatit raporte të ndryshme sipas nevojës së kryetarit, këshillit bashkiak; komunikimit me publikun apo kërkesave nga institucionet e qeverisjes qendrore;
Ndihmon në monitorimin e planit të përgjithshëm vendor me anë të treguesve të performancës;
Ndërvepron me dhe asiston me strukturat përgjegjëse specifike gjatë procesit të hartimit të projekt buxhetit afatmesëm dhe monitorimit të ekzekutimit të buxhetit me të dhëna teknike;
Mbështet proçesin e konsultimit të dokumentave strategjikë dhe programit buxhetor vjetor apo afatmesëm me aktorët dhe grupet e interesit, si dhe në mënyrë të veçantë, përgatit draftet e integruara të raporteve vjetore të performancës.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. PLANIFIKIMIN *(nëse ka)*

Planifikon orarin e punës duke bërë ndarjen e duhur të kohës midis aktiviteteve qe duhet te permbushe.

B. DETYRAT TEKNIKE

Specialisti duhet të diskutojë me përgjegjësin e sektorit per cdo problem qe has ne punen e tij.

## III. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Zbaton me perpikemeri ligjet mbi te cilat operon sektori.

## IV. MJEDISI MENAXHERIAL

Raporton tek Përgjegjësi i Sektorit.

## V. MBIKQYERJA

Specialisti mbikëqyret për çështjet e caktuara nga Drejtori i drejtorisë

## VI. STAFI NËN VARËSI *(s'ka)*

VII. KUSHTET E PUNËS

Në përputhje me parimet e përgjithshme të kushteve të punës të përcaktuara në rregulloren e Institucionit.

KËRKESAT E POSAÇME

***Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:***

**Arsimi:** *Ekonomik, Drejtësi, Finacier,Kontabilist etj*

**Tjetër:**

- Të ketë eksperiencë 5 vjet dhe notë mesatare mbi 8.
- Të ketë njohuri mjaft mira të gjuhës angleze, preferohet njohja e një gjuhe të dytë të BE.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

## 1. Dokumentet, mënyra dhe afati i dorëzimit

a) Letërmotivimi për aplikim në vendin vakant;
b) Nje kopje jetëshkrimi;
c) Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
d) Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë te njehsuar atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
e) Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
f) Nje kopje e librezës së punës e plotësuar;
g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
h) Certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
i) Dëshmi të njohjes së një gjuhe të huaj;
j) Fotokopje e kartes se identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi "Liria", 2000 Durrës

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për pranimin nga jashtë shërbimit civil duhet të bëhet brenda datës: 13.01.2025**

## 2. Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **15.01.2025**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën

për konkurimin për kete pozicion, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

## 3. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Kodin e Procedurave Administrative
Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar
Ligji nr. 44/2014 datë 24.4.2014 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"
Ligjin nr. 9131 dt. 08.5.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" Ligji 139 dt. 17.12.2015 ''Për vetqeverisjen vendore'' i ndryshuar
Ligji 17/2018 "Për statistikat zyrtare"
Ligji 30/2022 "Per miratimin e programit te statistikave zyrtare 2022-2026" Ligji 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale" i ndryshuar

## 4. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

***a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (15 pikë)***

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperienca, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

***b) Vlerësimi me shkrim: (60 pikë)***

***c) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (25 pikë)***

✓ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
✓ Eksperiencën e tyre të mëparshme;
✓ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

## 5. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.
Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail).

A.K.P.A.
Nr 2/10 Prot.
Datë,më 06 01 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 17717/1 Prot., Lezhë, më 30. 12. 2024

Lënda: **Kërkesë për publikim**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

***TIRANË***

Bashkia Lezhë në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, ka përfunduar procedurën e pranimit në shërbimin civil, për shpalljen e shpallur për konkurim, *lloji i diplomës "Shkenca Shoqërore/Sociale", niveli minimal i diplomës "Bachelor"*, për pozicionin:

1. **Specialist Protokolli, Sektori i Protokoll-Arkivit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Bashkia Lezhë , Kategoria IV-2.**

Për sa më sipër, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", listën e kandidatëve fitues për këtë procedurë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**
**Pjerin Ndreu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr._____Prot. ,                                                                 Lezhë, më _____._____.2024

# NJOFTIM FITUESI PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)

## Lloji i diplomës "Shkenca Shoqërore/Sociale"
## Niveli minimal i diplomës "Bachelor"

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Raportit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit për shërbimin civil në Bashkinë Lezhë të datës 27.12.2024, Njësia përgjegjëse në Bashkinë Lezhë, në përfundim të procedurës së pranimit në shërbimin civil, njofton se për pozicionin e shpallur për konkurim:

1. **Specialist Protokolli, Sektori i Protokoll-Arkivit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Bashkia Lezhë, Kategoria IV-2.**

Lista e kandidatëve fitues është si më poshtë:

1. **Marinela Zeka,**
2. **Natasha Cungu.**

Kandidatët që kanë marrë më pak se 70 pikë do të njoftohen me email për rezultatet e marra.

**DREJTORI**
**Jetmira Leka**

A.K.P.A.
Nr 2/11 Prot.
Datë.më 06 01 .2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr.5802/1 prot. Gramsh, më 27. 12.2024

Lënda: Njoftim për shpallje të procedurave "Ngritje në Detyrë dhe Pranim në Shërbimin Civil" në Kategorinë e Lartë Drejtuese, Bashkia Gramsh.

**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Adresa:Bulevardi "B.Curri" pranë ish-Hotel "Arbana"**

**TIRANË**

Bashkëlidhur Ju dërgojmë Njoftimin nr.5802/1, datë 24.12.2024 "Shpallje për Ngritje në Detyrë dhe Pranim në Shërbimin Civil" në Kategorinë e Lartë Drejtuese për pozicionin –Sekretar i Përgjithshëm, kategoria I-5, në Bashkinë Gramsh.

Afati i dorëzimit të dokumenteve, vendi, data dhe ora ku do të zhvillohet konkurrimi me procedurën e "Ngritje në Detyrë dhe Pranim në Shërbimin Civil" dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve, mbeten ato të shpallura në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh (www.bashkiagramsh.gov.al), me shkresën nr.5802, datë 24.12.2024 "Shpallje për Ngritje në Detyrë dhe Pranim në Shërbimin Civil" në Kategorinë e Lartë Drejtuese për pozicionin –Sekretar i Përgjithshëm, kategoria I-5, në Bashkinë Gramsh

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t'ju niset edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@akpa.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA GRAMSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr.5802 prot. Gramsh më 24/12/2024

# SHPALLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË KATEGORINË E LARTË DREJTUESE NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL (SEKRETAR I PËRGJITHSHËM)

**Lloji i diplomës "SHKENCA JURIDIKE"**
**Titulli minimal i diplomës "MASTER SHKENCOR"**

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nivelit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", ndryshuar me VKM nr. 388, datë 06.05.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.118, datë 05/03/2014", Vendimin nr. 84 datë 05.12.2024 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 09, datë 28.02.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2024", Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së lartë drejtuese nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil:

**SEKRETAR I PERGJITHSHEM KATEGORIA E PAGËS I-5.**

***Pozicioni më sipër u ofrohet nëpunësve civilë të nivelit të mesëm drejtues nepërmjet ngritjes në detyre si dhe kandidateve jashtë shërbimit civil që plotësojne kriteret për të njëjtën kategori!***

**PËR TË DYJA PROCEDURAT (NGRITJE NË DETYRË, JASHTË SHËRBIMIT CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave: 23.01.2025**
**(brenda një periudhe 30 ditore nga momenti i shpalljes në portal)**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

## I. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Sekretari i Përgjithshëm në njësi të qeverisjes vendore është nëpunësi më i lartë civil në institucion: ai raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te titullari i institucionit; përveç detyrave të veçanta të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, ka rol kryesor në formulimin e politikave dhe zbatimin e tyre: koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga një numër drejtorish, të cilat kanë lidhje midis tyre, gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës që mbulon institucioni; siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat, duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve; siguron zbatimin e programeve sektoriale dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre; siguron drejtim strategjik afatgjatë; identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve, për përmirësim të politikave, programeve dhe performancës institucionale; menaxhon drejtpërsëdrejti drejtorët e drejtorive përmes procesit të raportimit dhe delegimit; menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të institucionit; organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësive kryesore administrative; siguron një klimë bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirjeje të stafit dhe promovon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore; është përgjegjës për ristrukturimin organizativ të institucionit; miraton përshkrimet e punës së nëpunësve të institucionit; garanton respektimin e afateve në nxjerrjen e akteve administrative; promovon iniciativa për përmirësimin e shërbimeve me publikun; përfaqëson institucionin, me autorizim të titullarit, brenda dhe jashtë vendit; kryen detyra të tjera të ngarkuara me urdhër të titullarit.

## II. DETYRAT KRYESORE

### Sekretari i Pergjithshem

- Sekretari i Përgjithshem ka detyrë kryesore hartimin e politikave kryesore të drejtimit te institucionit.
- Drejton dhe koordinon veprimtarite e Drejtorive dhe sektoreve përkates të Institucionit.
- Drejton dhe mbikëqyr veprimtarine e zhvillimit te proçedurave të prokurimit publik dhe ankandeve bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi.
- Kontrollon dhe mbikqyr procedurat e ndjekura ne baze te ligjit "Kodi i Punes" gjatë fazës së zhvillimit të konkurimit, kritereve të pjesëmarrjes dhe vlerësimit të konkurentëve në përputhje me kriterin e meritokracisë dhe transparencës.
- Harton në bashkpunim me strukturen përgjegjëse politikat zhvillimore në fushën e turizmit.

- Përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të Bashkise, nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cënuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre;
- Gjate ushtrimit te detyres identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve te institucionit dhe per nje menaxhim sa me te mire te fondve bashkiake.
- Koordinon veprimtarine e Njesive Administrative me administraten Bashkiake duke siguruar efektivitet dhe shpejtesi ne kryerjen e detyrave.
- Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditëshme si dhe shqetësime te ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon eprorit, rrugëzgjidhjet, përkatëse
- Harton dhe propozon rregulloren per organizmin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës Gramsh.
- Kryen verifikimin e saktësisë, në formë dhe në përmbajtje të të gjitha materialeve te trajtuara nga strukturat përgjegjëse në bashki, përpara nënshkrimit të tyre nga kryetari.
- Koordinon brenda kompetencave të dhëna marrëdheniet me institucionet e tjera shtetërore dhe ndërkombëtare.
- Kryen detyra ligjore dhe institucionale qe i ngarkon Kryetari i Bashkise.
- Bashkëpunon me drejtoritë/sektoret përkatese për respektimin e proçedurave dhe afateve ligjore ne ushtrimin e veprimtarive administrative në përputhje kodin e proçedurave dhe legjislacionin ne fuqi.

**1.1 Kriteret e përgjithshme dhe të vecanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë, nga të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

**Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:**

a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-2),

b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi,

c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë",

ç- Të mos kenë proçese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

**Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion:**

1. Nëpunes civilë të kategorisë së mesme drejtuese, të cilët duhet të plotësojne kriteret si vijon:

a.Të kenë të paktën 10 (dhjetë) vite përvoje pune në Administratën Publike.

**Kandidate nga jashte sherbimit civil, të cilet duhet të plotësojne kriteret minimale si vijon:**

a. Të plotësoje kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në germat "a" deri nje "dh" te nenit 21 te ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar,

b. Të zotërojë një diplomë të nivelit "Master shkencor" në shkenca juridike ose te barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit te larte. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njëhsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*

c. Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera te vetëqeverisjes vendore në nivele drejtuese ose të barazvlefshme me to, etj.

## 1.2 DOKUMENATACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vacant:

2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta:

3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;

5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

8.Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

9.Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 23.01.2025***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe në datën 03.02.2025 do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë saj për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

## 1.4 Data për paraqitjen e aplikimit

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë Gramsh brenda datës 23.01.2025.

## 1.5 Data e zhvillimit të konkurrimit

Konkurrimi do të zhvillohet në mjediset e Bashkisë Gramsh në datën 26.02.2025. Kandidatët do të njoftohen individualisht mbi orarin.

## 1.6 Data për shpalljen e rezultateve

Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 28.02.2025.

## 1.7 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

**A. Ligjet:**

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";

- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

- Legjislacionin mbi auditimin;

-Legjislacionin tatimor;

- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);

- Kodin e Procedurave Administrative;

- Legjislacionin e prokurimit publik;

- Legjislacionin për menaxhimin financiar;

- Legjislacionin për rregullat e etikës në administratën publike (ligji nr. 9131, datë 08/09/2003). - Njohuri për sistemin ligjor evropian.

**B.Aftësite per te:**

-Drejtuar dhe menaxhuar skuadren;

-Organizuar dhe ndare punen ne institucionin qe drejton;

- Menaxhuar situata emergjente;

-Marre vendime ne baze te argumenteve;

-Krijuar procedura apo politika te reja;

-Ndermarre nisma te ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kopetencave te funksionit me qellim permbushjen e detyrave funksionale.

## 1.8 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 50 pikë;

c- Vleresimin e jetëshkrimit, që perfshin në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 10 pikë.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje synojne vleresimin e njohurive, aftesive dhe cilesive te lidhura me fushen perkatese.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 6, datë 19.09.2014, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

## 1.9 DATA E ZHVILLIMIT TE KONKURIMIT

Testimi me shkrim do te zhvillohet ne datën 26 Shkurt 2025 në orën 11:00 në ambientet e Bashkisë Gramsh. Pas zhvillimit të testimit me shkrim kandidatet do të njoftohen nëpërmjet adresës së tyre të email-it në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

## 1.10 DATA E SHPALLJES SE REZULTATEVE PER VLERESIMIN PERFUNDIMTARE

**Lista e fituesve me mbi 70 (shtatëdhjetë) pikë do të shpallet në datën 28.02.2025**

Njoftimi do të bëhet në portalin "AKPA", në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

**KRYETARI**

**Besion AJAZI**

A.K.P.A.
Nr 2/12 Prot.
Datë,më 06 01 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VORË**
**KRYETARI**

Nr. 6827 prot. Vorë, më 27. 12. 2024

**Lënda: Njoftim për publikim**

**AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**Tiranë**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ligjit Nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", ligji nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, po ju dërgojmë për publikim në portalin Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, njoftimin për verifikimin paraprak për aplikimet në pozicionin:

- **1 ( një) Inspektor i Policisë Bashkiake.**

1. Në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, pas verifikimit paraprak per përmbushjen e kritereve për kualifikim njofton se kandidati për të vijuar për fazën e dytë të testimit me shkrim është:

**Z. Eduart Troci**

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 07.01.2025 ora 10:00, ne mjediset e sallës së mbledhjeve të Bashkisë Vorë.

Pas testimit me shkrim kandidati nëse plotëson pikët e kërkuara do të kaloi për fazën e tretë në intervistën e strukturuar me gojë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

**K R Y E T A R**
**Blerim SHERA**

**ME URDHËR ME DELEGIM**
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**
**Taulant Fejzulla**

A.K.P.A.
Nr 2/13 Prot.
Datë,më 06 01 2025

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS**

Nr 2052/6 Prot.

Tiranë, më 30.12.2024

**Lënda:** Kërkesë për publikim njoftimi

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
Bulevardi "Bajram Curri", Pranë Ish Hotel Arbana, Tiranë

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.152/2013, të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.03.2015, *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, ka përfunduar fazën e vlerësimit, të kandidatëve të kualifikuar në *procedurën e pranimit në shërbimin civil*, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e shpallur për konkurim.

Për sa më sipër, bashkëlidhur ju dërgojmë për publikim në portalin "Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive", njoftimin për shpalljen e fituesit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Sofi Noti**

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

**NJOFTIM FITUESI PËR
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Institucionin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në përfundim të fazës të dytë të vlerësimit, të kandidatëve të kualifikuar, nëpërmjet intervistës së strukturuar me gojë, për *procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil* në kategorinë ekzekutive, për pozicionin **Specialist, Sektori i Kërkesave për Qëllime Studimore, Media**, njofton se:

- kandidati fitues është;

- **Znj. Gerla Kotka**

A.K.P.A.
Nr 2/14 Prot.
Datë,më 06 01 .2025

REPUBLIKA E SHQIPERISE
**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE**

Nr.3389/1 Prot.  Tiranë, më 30.12.2024

Lënda: Kërkesë për publikim.

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Bulevardi "Bajram Curri", Pranë Ish Hotel Arbana**

**Tiranë**

Në zbatim të 26, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të VKM-së nr.242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, bashkëlidhur, lutemi, të gjeni për publikim në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", shpalljen e procedurës së konkurrimit, për pozicionin si më poshtë:

- 1 (një) Drejtor, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Kategoria II-1.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE**
**NGRITJE NË DETYRË**
**PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

**Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të VKM nr.242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**1 (një) Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - klasa: II-1.**

*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, pozicioni është ende vakant, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**09/01/2025**

**LËVIZJE PARALELE**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**14/01/2025**

**NGRITJE NË DETYRË**

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përgjigjet për miradministrimin e veprimtarisë ekonomike, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, procedurave të prokurimeve dhe shërbimeve të tjera mbështetëse të institucionit, dhënien asistencë për të gjithë personat që paraqiten pranë institucionit ose në telefon për të paraqitur ankesë, si dhe arkiv-protokollin.
- Drejton dhe kontrollon shërbimet e nevojshme për stafin e institucionit.
- Ndjek mirëmbajtjen e pajisjeve,duke mbajtur kontakt me specialistët ë fushave të ndryshme që kontraktohen për riparime.
- Organizon punën përplotësimin e nevojave të institucionit për lëvizje dhe mbajtjen në gatishmëri të burimeve, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve periodike.
- Ndjek procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, të parashikuara në legjislacionin përkatës.
- Siguron planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për të gjitha fondet e parashikuara në buxhetin, të planifikuara për mallra, shërbime dhe ndërtime të nevojshme për institucionin, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe legjislacionit në fuqi
- Siguron përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit dhe kujdeset që sistemi të përdoret nga stafi institucionit.
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave dhe realizimin e shërbimeve të arkiv-protokollit.

## 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

## 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

a) Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës klasë II;
b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit,*

*duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*

b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion.
c) Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
d. Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
e. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
g. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
h. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi;
k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, brenda datës 09.01.2025.

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën *10/01/2025*, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur proçesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, *"Për proçesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur"*, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit, nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikë), në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

## 2 NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

*Këtë informacion do ta merrni në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data **24/01/2025.***

## 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar klasa III-1 ose III-2.
b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" ose "Shumë mirë";

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion.

c) Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a. Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
d. Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
e. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
f. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
g. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
h. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
i. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
j. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi.
k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, brenda datës 14.01.2025.

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.***

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën *24/01/2025,* njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## 2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në*

*kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

